



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:092684

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05510473

P.nr.298/2018

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Medina Rama, në çështjen penale kundër të pandehurit K. A., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 e lidhur me par. 1 të Kodit Nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje si: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1295/2018 e datës 20.04.2018, jashtë seancës, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 par.1 nën par 1.3 të KPP-së, me datën 27.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1295/2018 e datës 20.04.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurit: K. A., nga i ati M., e ëma S., e gjinisë A., i lindur me datë ... në Egjipt, arab, shtetas i Egjiptit, me nr. personal ..., me nr. personal të letërnjoftimit të Kosovës ..., me vendbanim në fshatin F., komuna e Mitrovicës, për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, **për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.**
- II. Shpenzimet e procedurës penale, mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Pala e dëmtuar Sh. Xh. A., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë- Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1295/2018 të datës 20.04.2018, kundër të pandehurit: K. A., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjyqtarja e çështjes, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare përkritazi me afatet e parashkrimit ka konstatuar se në këtë lëndë penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të pandehurin K. A., për shkak të veprës penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Në këtë çështje penale gjyqtarja e çështjes, ka caktuar seancat e shqyrtimit fillestar me datat 12.10.2023, 03.11.2023, 04.12.2023 dhe 20.12.2023. Gjykata ka tentuar që të pandehurit K.A., t'ia dorëzoj ftesat në mënyrë të rregullt, mirëpo ka qenë e pamundur.

Në mënyrë që të sigurohet prezenca e të pandehurit në seancën e shqyrtimit fillestar, gjykata me datë 05.12.2023 ka lëshuar urdhëresë për sjellje me forcë për të pandehurin K. A., përmes Policisë së Kosovës, Stacioni Policor Mitrovicë- Jugu.

Policia e Kosovës, Stacioni Policor Mitrovicë- Jugu, me datë 20.12.2023, përmes Raportit të Oficerit, e kanë njoftuar këtë gjykatë se njësia e Policisë ka bërë verifikimin për të pandehurin K. A. në sistemin e PK-së, ku është siguruar një fotografi e tij dhe aty figurojnë dy numra kontaktues mirëpo të njëjtit nuk janë të qasshëm. Në raportin e oficerit thuhet se njësia e policisë kanë dalur në teren dhe kanë shkuar në fshatin F., ku aty kanë kontaktuar me disa banorë të cilët i kanë pyetur në lidhje me të pandehurin mirëpo ata kanë deklaruar se nuk e njohin personin në fjalë. Tutje kanë theksuar se në sistem figuron se i pandehuri K. A. në vitin 2018 ka qenë i përfshirë në një rast ku gjatë deklaratës në polici i njëjti ka deklaruar se tani adresën e vendbanimit e ka në Stamboll, Turqi.

Meqenëse prezenca e të pandehurit në procedurë nuk ka mundur të sigurohet, Gjykata Themelore në Mitrovicë me datë 26.12.2023, ka lëshuar Urdhërarrest ndaj të pandehurit K. . duke e urdhëruar Policinë e Kosovës që posa ta has të pandehurin, ta arrestoj dhe menjëherë të shoqërohet në Gjykatën Themelore në Mitrovicë- Departamenti i përgjithshëm (Objekti në Veri), dhe ka urdhëruar ekzekutimin e tij nga stacioni policor në Mitrovicë- Jugu, duke vlejtur për të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, pa asnjë kufizim. Ky urdhërarrest i është dorëzuar Policisë së Kosovës, Stacioni Policor Mitrovicë Jugu, me datë 26.12.2023, mirëpo deri më sot gjykata nuk ka pranuar ndonjë njoftim nga ana e tyre.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se i pandehuri K.A. veprën penale dyshohet t'a ketë kryer me datë 25.03.2018 dhe që nga ajo kohë e deri më tani kanë kaluar mbi gjashtë (6) vite.

Në nenin 106 paragrafi 1 nën par 1.5 të KPRK-së, është përcaktuar se *“ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”* dhe neni 107 paragrafi 8 përcakton se *“ Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit ”.*

Në rastin konkret i pandehuri K. A. është akuzuar me dyshimin se ka kryer veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 e lidhur me par. 1 të KPRK-së, ku dënimi i

përcaktuar me këtë kod për këtë vepër penale është *me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet*, ndërsa vepra penale dyshohet se është kryer me datë 25.03.2018, dhe që nga koha e dyshimit se i pandehuri ka kryer veprën penale të lartcekur e deri më sot kanë kaluar mbi gjashtë (6) vite, e që ka kaluar dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit, çka do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 106 paragrafi 1 nën par 1.5 lidhur me nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së.

Përkundër ndërmarrjes së të gjitha veprimeve procedurale nga ana e kësaj gjykate lidhur me këtë çështje penale, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Parashkrimi absolut në këtë rast penal ka arritur me datën 25.03.2024, ngase brenda kësaj periudhe kohore nuk ka përfunduar ndjekja penale.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurit të lartcekur, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër penale që është akuzuar, kjo Gjykatë ka marrë aktvendim, e ka hedhur akuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e mori duke u bazuar në nenin 462 par. 3 të KPP-së.

Andaj, në bazë të lartcekurave, në kuptim të nenit 106 par.1 nën par 1.5 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së, si dhe nenit 357 par 1. nën par 1.3 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.298/2018, datë: 27.03.2024

G j y q t a r j a
Benita Berisha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.